



UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEKA" UNIVERSITY
Zija Shemsiu, 60000, Gjilan, Kosovë
www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

Këshilli Drejtues: PhD.Can. Agron Hajdari, Kryesues i KD Ref.nr. 02/2295 / 11 / 11 / 2022

Këshilli Drejtues i Universitetit Publik "Kadri Zeka" në Gjilan, në mbledhjen e mbajtur më datë 08.11.2022, mori vendim të shpall:

KONKURS

Për ndarjen e bursave universitare për nivelin baçelor dhe master për vitin akademik 2021/22

I. Të drejtë aplikimi për bursë universitare kanë studentët e nivelit baçelor dhe master të cilët i plotësojnë këto kushte:

1. Të jenë studentë të rregullt;
2. Të jenë studentë të vitit të dytë e më lartë;
3. Të mos kenë vit të përsëritur;
4. Të kenë të përfunduara të gjitha provimet e vitit paraprak të studimeve në afatin e shtatorit.

II. Studentët duhet plotësuar edhe kriteret shtesë të aprovuara nga Senati i UKZ-së, më dt.10.11.2022 dhe atë:

- Studentët e Fakultetit të Edukimit, Fakultetit Ekonomik dhe Fakulteti Juridik në të dy nivelet baçelor dhe master duhet të kenë notën mesatare së paku 9.00;
- Studentët e Fakultetit të Shkencave Kompjuterike në të dy nivelet baçelor dhe master si dhe Fakulteti i Shkencave Aplikative duhet të kenë notën mesatare më së paku 8.50.

III. Këshilli Drejtues në takimin e mbajtur më 8.11.2022 e ka përcaktuar shumën e bursës në vlerën prej 800.00 euro.

IV. Studentët të cilët i plotësojnë kushtet nga pika I dhe pika II e konkursit duhet të paraqesin këto dokumente:

- Formularin e plotësuar (shkarkohet nga ueb faqja zyrtare e universitetit);
- Vërtetimin për statusin e studentit (lëshohet nga fakulteti);
- Pasqyrën e provimeve të dhëna (lëshohet nga fakulteti).

V. Afatet e konkursit

- Aplikimi për bursë universitare bëhet nga datat 14.11.2022 deri më 18.11.2022 ora 16:00.
- Dorëzimi i dokumenteve bëhet në fakultetin përkatës.

